



Dalës-Izlazna

Nr.
Br.

X-597

Data
Datum

19.07.2019

OBILIC-OBILIC



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republik of Kosova
Komuna e Obiliqit/Opština Obilic/Municipality of Obiliq



Bazuar në nenin 8, paragrafi 1 dhe 2, të Ligji i Punës, nr.03/L -212, neni 5, paragrafi c, Ligji për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, neni 35, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr.04/L-032, Udhëzimet Administrative të MASHT-it, nr.17/2009, nr.10/2018, UA nr.07/2017 rregullimi i procedurave të konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria e Arsimit me datë 20.07.2019, shpall :

KONKURS

(Për plotësimin e vendit të punës)

SHFMU "Naim Frashëri " në Breznicë

- Një mësues klase, në PNF Kozaricë

SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova" Obiliq

- Një mësues klase, zëvendësim i pushimit të lehonisë

SHFMU "Pandeli Sotiri" Obiliq i Vjetër

- Një arsimtar të gjuhës gjermane

SHFMU " Hasan Prishtina " Milloshevë

- Një arsimtar të gjuhës gjermane, zëvendësim i pushimit të lehonisë

Gjimnazi "17 Shkurti " Obiliq

- Një profesor për Sociologji, Filozofi dhe Logjikë, (Sociologji 5 orë, Filozofi 6 orë dhe Logjikë 1 orë)

Kushtet :

Kërkohet kualifikimi profesional përkatës, sipas Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ(MASHT), nr.10/2018,për normativin mbi kuadrin profesional të Arsimit të Përgjithshëm.

Kandidatët që konkurojnë për mësimdhënës duhet të sjellin kopjen e diplomës së fakultetit të vërtetuar,vërtetimin për përvojën e punës, certifikatën e lindjes, dokumentin e letërnjoftimit.

Kandidatët, të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, të cilët nuk i kanë diplomat e nostifikuara në MASHT nuk do të përfshihen në listën e ngushtë.

Fletëkërkesat merren në zyrën e pranimit të KK-së dhe dorëzohen me dokumentet të kompletuara në të njëjtën zyrë. Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e publikimit në shtyp.

Drejtori :Agim Spahiu